



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË  
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. 843 prot.

Tiranë, më 27.03.2024

**NJOFTIM ME SHPALLJE**

**TË VENDIMIT NR. 2260/3, DATË 30.10.2023 TË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË, “PËR PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT TË ANKESËS SË PARAQITUR NGA SHTETASI Z. BESIM LIKA ”**

Inspektori i Lartë të Drejtësisë ka marrë në shqyrtim ankesën e paraqitur të z. Besim Lika me nr. 169 prot., datë 22.01.2021 në të cilën ngrihen pretendime ndaj veprimtarisë gjyqësore të ish magjistratit M.LL, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, në kohën e kryerjes së shkeljes së pretenduar dhe me vendimin nr. 2260/3 prot., datë 30.10.2023 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për përfundimin e procedurës së verifikimit pa një vendim përfundimtar të ankesës së paraqitur nga shtetasi z. Besim Lika” bazuar në nenin 122, pika 4 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenin 95 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe nenin 214 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, ka vendosur përfundimin e procedurës së verifikimit të ankesës pa një vendim përfundimtar. Vendimi duhet t’i njoftohet ankuesit, brenda 5 ditëve nga marrja e tij. Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, brenda 1 jave nga marrja e njoftimit të tij.

Meqenëse nuk është arritur njoftimi i vendimit në adresën e komunikuar nga ankuesi, bazuar në parashikimet e nenit 162 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, bën njoftimin publik të vendimit, nëpërmjet kësaj shpallje për një afat 10 ditor. Njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes.

Njoftimi i vendimit me shpallje publikohet:

- një kopje në këndin e njoftimeve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- një kopje në këndin e njoftimeve të Bashkisë Mat, sipas adresës së lënë nga ankuesi; Lagjja “Pjetër Budi”, Burrel;
- në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë: [www.ild.al](http://www.ild.al).

Shpalljet që do të afishohen, hartohen në dy kopje me qëllim që një prej tyre të kthehet në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nënshkrimin dhe datën që shpallja u afishua.

**SEKRETAR I PËRGJITHSHËM**

